



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

№/Br. 200/22
Date/Datum 28.07.22

PRISHTINË - PRIŠTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.200/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të znj. Kimete Gashi – Kryetare paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Albkos Safety” SH.P.K.– Fushë Kosovë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furzim me pajisje dhe mjete për zjarrëfikje”, me nr. të prok: VU644-22-4841-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Vushtrri”, më datën: 27.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Albkos Safety” SH.P.K.– Fushë Kosovë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furzim me pajisje dhe mjete për zjarrëfikje”, me nr. të prok: VU644-22-4841-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Vushtrri”.

II.ANULOHET, aktiviteti i prokurimi njoftimi për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furzim me pajisje dhe mjete për zjarrëfikje”, me nr. të prok: VU644-22-4841-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Vushtrri”, të Ritenderohet nëse AK ka interes.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me

Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Albkos Safety”SH.P.K.– Fushë Kosovë, i aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues: “Albkos Safety”SH.P.K.– Fushë Kosovë, që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “Albkos Safety”SH.P.K.– Fushë Kosovë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 11.06.2021 me nr. 200/22, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furzim me pajisje dhe mjete për zjarrëfikje”, me nr. të prok: VU644-22-4841-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Vushtrri”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 6 , 7 , dhe 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 14.06.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 22.06.2022, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “Albkos Safety”SH.P.K.–
Fushë Kosovë,

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues / KK-Vushtrrisë, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është furnizime. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për kontratë të aktiviteti të prokurimit, përkatësisht kundër aneksit 1 Specifikime teknike të detyrueshme. Operatori ekonomik me datë 02.06.2022, ka kërkuar sqarime shitesë për pozicionet 1, 2, 3 dhe 7 për arsyeje se këto pozicione janë përshtatur prodhueseve/OE të caktuar ekonomik, në kundërshtim me nenin 28 të LPP dhe nuk garantojnë pjesëmarrje të barabartë konkurrimi“, kurse më 06.06.2022 ka pranuar përgjigje nga AK-ja:

Përgjigjeja në Pyetjen / Çështjen 1.

Ne si Autoritet Kontraktues pas shqyrtimit të kërkesës, në konsultim edhe me njësinë kërkuese potencojmë se në specifikimin teknik nuk është cek ndonjë emër prodhuesi, model apo ndonjë element që kufizon ndonjë operator ekonomik, andaj specifikimi teknik është konform LPP dhe me nevojat të zjarfikësve. Specifikat janë të bazuaranë standarde të cilat duhet t'i plotësoj secili artikull në mënyrë që t'i përmbushi nevojat e Njësisë së Zjarfikësve.

Kërkesat janë minimale që duhet përmbushur, ndërsa mundesojnë që të ketë tolerance të mjaftueshme p produkte të ndryshme.

Për ofertim vlen çdo produkt që i plotëson ose i tejkalon specifikimet teknike dhe standardet në DT. Në artikullin në pozicionin 3. Temperatura e testimit duhet të sillet në kufijt : minimum -40°C deri +70°C sipas standardit, prandaj është e rëndësishme që paisja të përmbushë standardin EN 1876.

Pompa do të përdoret për shuarjen e zjarreve edhe në raste tjera, përveq atyre fushore dhe malore. Si dhe për jetegjatesi dhe qendrueshmeri me rastin e deponimit, bartjes, etj.

Per te gjitha pozicionet

Per ofertim vlen çdo produkt që i plotëson ose i tejkalon specifikimet teknike dhe Standardet e vendosur në Dosienc e Tenderit.

Operatori ekonomik ankues me date 08.06.2022 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë autoriteti kontraktues, ndërsa autoriteti kontraktues përmes përgjigjes se kërkesë për rishqyrtim të datës 10.06.2022 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtimi si të pabazuar.

PËRGJIGJE NË PRETËNDIM NR. 1

Për Pozicionin 1.

Eksperti shqyrtues vlerëson se duke u bazuar ne aneksin 1, specifikime teknike të detyrueshme dhe ne pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues për pozicionin 1. Pompe centrifugale, po ashtu dhe verifikimet e bere ne internet, konkretisht në ëebfaqen e prodhuesit “KUBE” P1 Gasoline - Kube Pompa , vlerësojë se autoriteti kontraktues ka përpiluar specifikime teknike për Pozicioni 1. Pompe centrifugale, duke ju referuar një prodhuesi të caktuar “KUBE” me ç ‘rast ka kufizuar pjesëmarrjen e operatoreve ekonomik të interesuar për këtë aktiviteti të prokurimit, andaj autoriteti kontraktues duhet te përpilojë specifikimet teknike konform NENI 28, paragrafi 2. Autoriteti kontraktues do ti përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit.

Për pozicioni 2.

Eksperti shqyrtues vlerëson se duke u bazuar ne aneksin 1, specifikime teknike të detyrueshme dhe ne pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues për pozicionin 2. Mjete për fikjen e zjarrit në baterilitium 36 V - 750 Ë/h, po ashtu dhe verifikimet e bere ne internet, konkretisht në ëebfaqen e prodhuesit <https://ëëë.emme-italia.com/en/6-l-foam-fire-extinguisher-stop-combustion-lithium-battery-22066-25>, po ashtu dhe për këtë pozicioni AK-ja përpiluar specifikime teknike duke ju referuar një prodhuesi të caktuar “Emme Anticindo Srl – Itali,” e qe është në kundërshtim me neni 28 dhe neni 7 si dhe me të gjitha dispozitat ligjore te LPP-së.

Eksperti shqyrtues vlerëson se autoriteti kontraktues për pozicioni 2 është dashur të rregulloje edhe emërtimin e produktit pasi kemi të bëjmë me aparat për fikjen e zjarrit, pra në vend të “Mjete për fikjen e zjarrit në baterilitium 36 V - 750 Ë/h” të vendos “Aparat për fikjen e zjarrit”.

Citoj: Prodhuesi Emme Anticindo Srl – Itali, ka bërë një test jo të detyrueshëm të një aparati me aditiv shkumë, siç mund të përdoren të mënyrë të njëjtë edhe aparatet tjera për fikjen e zjarrit në pajisjet elektrike dhe është i vetmi në botë i këtij lloji që mban një emërtim “... 36 V - 750 Ë/h”.

Duke qenë se edhe aparatet tjera të të njëjtës kategori mund përdoren për fikjen e zjarrit në automjete elektrike, nga përshkrimi duhet të hiqet emërtimi "... 36 V - 750 Ë/h" ngase ka karakter diskriminues (nuk ekziston standard) dhe shërben si pretekst për eliminim e konkurrencës.

Për pozicioni 3.

Eksperti shqyrtues vlerëson se duke u bazuar ne aneksin 1, specifikime teknike të detyrueshme dhe ne pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues për Pozicioni.3 Pompe shpinore, kapacitet 19 deri 20Litër, po ashtu dhe verifikimet e bere ne internet, konkretisht në ëbfaqen e prodhuesit "<https://ëëë.tipsa.com/product-category/genfo-backpacks/>." po ashtu dhe për këtë pozicion AK-ja përpiluar specifikime teknike duke ju referuar një prodhuesi të caktuar "Genfo " e qe është në kundërshtim me neni 28 dhe neni 7 si dhe me të gjitha dispozitat ligjore te LPP-se.

Për pozicioni 7.

Eksperti shqyrtues vlerëson se duke u bazuar ne aneksin 1, specifikime teknike të detyrueshme dhe ne pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues për Pozicioni.7 Pompa Ajër Fryrëse bartëse shpine, po ashtu dhe verifikimet e bere ne internet, konkretisht në ëbfaqen e prodhuesit "<https://ëëë.stihl.com/STIHL-poëer-tools-A-great-range/Cleaning-systems/Bloëers-and>" po ashtu dhe për këtë pozicion AK-ja ,përpiluar specifikime teknike duke ju referuar një prodhuesi të caktuar "produktin BR 600 të prodhuesit Stihl " e qe është në kundërshtim me neni 28 dhe neni 7 si dhe me të gjitha dispozitat ligjore te LPP-së.

Andaj, parametrat teknik dhe dimensionet e kërkuara janë favorizues duke ju referuar prodhuesve te caktuar në kundërshtim me neni 7 i LPP-së, prandaj kërkojmë që rëndësia ti jepet produktit, që konform nenit 28 te LPP paragrafi 2 ne mënyre që këto specifika të jenë të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mire për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit, të lejohen parametra tjerë teknik, duke mos ndikuar në performancë të pajisjes.

Eksperti shqyrtues vlerëson se një specifikacion i tille i përpiluar nga autoriteti kontraktues është në kundërshtim me neni 1, neni 7 dhe neni 28 si me të gjitha dispozitat ligjore të LPP-së si dhe RRUOPP- së, që favorizon ose diskriminon një ose më shumë Operatorëve ekonomik të interesuar apo tenderues.

Prandaj, vlerësojë që AK, është dashur të përpilojë specifikime teknike sipas nevojave të tyre, në mënyre që të kenë qasje të barabartë të gjithë OE të interesuar dhe tenderuesit që të ofrojnë zgjidhjen e tyre.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa të anulohet njoftimi për kontratë dhe të urdhërohet AK të bëjë korrigjimet e dosjes së tenderit dhe vazhdimin e afatit për ofertim në pajtim me nenit 53.7 të LPP-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 22.06.2022, me raportin e ekspertizës. Autoriteti Kontraktues, me datë: 27.06.2022, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: “Albkos Safety”SH.P.K.– Fushë Kosovë ,me datë: 22.06.2022, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca e mbyllur është mbajtur me datën: 25.07.2022, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, 01/2022 me nr. protokolli 83/20, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Paneli shqyrtues sa i perketete pretendimi 1 duke u bazuar konkretisht ne mendimin profesional te ekspertit ku ka vlerësuar se AK ka përpiluar specifikime teknike duke ju referuar një prodhuesi të caktuar “KUBE” me ç ‘rast ka kufizuar pjesëmarrjen e operatoreve ekonomik të interesuar për këtë aktiviteti të prokurimit, andaj paneli shqyrtues urdhëron autoritetin kontraktues që të zbatoj dispozitat ligjore nga Neni 28 par.2 i LLP-së dhe te përpilojë specifikimet teknike

Ndersa sa i perketete pretendimit paneli shqyrtues përsëri duke marrë për bazë mendimin e ekspertit, në këtë pretendim paneli konstaton se nuk janë respektuar dispozitat ligjore nga neni 28 par.2 i LPP-së.

Paneli shqyrtues sa i perketete pretendimit te 3-të , në bazë të mendimi të ekspertit teknik i cili ka vlerësuar se edhe ne këtë pozicion AK ka përpiluar specifikime teknike duke iu referuar nje prodhuesi te caktuar e në këtë rast prodhuesit “GENFO” , paneli konstaton se nga autoriteti kontraktues nuk janë respektuar dispozitat ligjore nga neni 7 dhe neni 28 i LPP-së

Paneli shqyrtues edhe ne pretendimin e 7 (4) konkretisht bazohet ne përgjigjen e ekspertit teknik i cili ka vlerësuar se AK- edhe për ketë pozicion ka përpiluar specifikime teknike duke ju referuar një prodhuesi të caktuar “produktin BR 600 të prodhuesit Stihl ” e që edhe në këtë rast paneli konstaton se edhe ky pretendim i OE është i bazuar dhe është përpiluar si kërkesë nga AK në kundërshtim me nenin 7 dhe neni 28 gjitha dispozitat ligjore te LPP-së

Bazuar në përgjigjet e mësipërme , paneli shqyrtues obligon AK që të bëjë korrigjimet e dosjes së tenderit duke respektuar dispozitat ligjore të LPP-së në tërësi dhe në veqanti dispozitat ligjore nga neni 1 , neni 7, neni 28 dhe neni 53 i LPP-së.

AK në rast të ritenderimit të këtij aktiviteti të bëjë korigjimet e dosjes se tenderit dhe specifikat të jenë të detajuara, paanëshem me qëllim të drejtë për të për të gjithë operatorët ekonomik .

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – “ Komuna e Vushtrrisë”,
- 1x1 OE - “Albkos Safety”SH.P.K.– Fushë Kosovë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.


Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
znj. Kimete Gashi